



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
G.J.P "AUTOBUSKA STANICA" A. D.
M.P.E "BUS STATION" J. S.

Nr. 04/1652 Data 11.10.23
No. Date

PRISHTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 31/15 qershor 2008), Ligjit 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, të nenit 182 të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare dhe nenit 56 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 i Ligjit 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobuseve" Sh.A. në përbërje të Arben Kqira, Donjeta Dragusha dhe Amir Simnica, në mbledhjen e mbajtur më 11 Tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Anulohet Vendimi mbi anulimin e konkursit të shpallur me datë 24.01.2023 për përzgjedhjen e 4 anëtareve të Bordit të Drejtoreve dhe rishpalljen e konkursit nr. 02/761 i dt. 15.05.2023
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Komisioni Komunal i Aksionareve të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. me datën 14.11.2022, kishte shpallur konkurs publik për përzgjedhjen e katër (4) anëtareve të Bordit të Drejtoreve të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A.

Me vendimin nr. 02/81 të datës 23.01.2023, ky konkurs ishte anuluar si shkak i mungesës së dokumentacionit të kandidatëve aplikues ku me të njëjtin vendim konkursi ishte

rishpallur me datën 24.01.2023 ku pas zhvillimit te procedurave, gjithsej 24 kandidatë kishin plotësuar kriteret për tu intervistuar ku katër (4) prej të cilëve kishin arritur të grumbullonin pikët maksimale për tu përzgjedhur.

Komisioni Komunal i Aksionareve, pas mbledhjes se mbajtur me datën 12.05.2023, ka anuluar konkursin e datës 24.01.2023 për përzgjedhjen e 4 anëtareve dhe kishte rishpallur të njëjtin.

Tre nga kandidatet e përzgjedhur për Bord te Drejtoreve te NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. kishin ushtruar padi në Gjykate, duke kërkuar anulimin e Vendimit me nr. 02/761 te datës 15.05.2023 me propozim për shtyrjen e ekzekutimit te tij ku Gjykata Themelore në Prishtine, me datën 30.05.2023 kishte aprovuar si të bazuar propozimin e paditësve/propozuesve për shtyrjen e ekzekutimit te Vendimit, pasi që të njëjtit kishin ofruar argumente të besueshme dhe kishte shtyrë ekzekutimin e Vendimit me nr. 02/761 te datës 15.05.2023 deri në vendosjen me vendim përfundimtar.

Me qëllim të funksionalizimit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A. dhe në përputhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr. 1003/2023, Komisioni Komunal i Aksionarëve vlerëson se është në dobi të të gjitha palëve funksionalizimi dhe emërimi i Bordit të Drejtorëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

U dorëzohet:

- Të emëruarve;
- Në dosje.

KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE:

- Arben Kqira
- Donjeta Dragusha
- Amir Simnica

